

**PKR.nr.20/18**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** gjykata e shkallës së parë penale me kryetaren e trupitgjykues Suzana Çerkini, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Albulena Ademi në çështjen penale kundër të pandehurës F.M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPRK, të akuzuar sipasAktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.87D/2013 të datës 26.06.2015, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 26.07.2018, me praninë e Prokurorit të shtetit Besa Limani dhe të pandehurës F.M., me mbrojtësin me autorizim av.A.R., të njëjtën datë, mori dhe shpalli publikisht këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**E pandehura F.M.,** e bija e H. dhe nënës E., e vajzërisë H., e lindur me ... në P., e martuar në M. dhe jeton në I., ka të kryer shkollën e mesme, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare – shtetasee Republikës së Kosovës, e i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ...,

## **ËSHTË FAJTORE**

**Sepse,** me datë 12.12.2010, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në Qendrën e Vendvotimit 0901E/05R, në shkollën fillore “S.R.” në F. K., në bashkëkryerje me të pandehurit Y.H., F.I., H.B., F. L.-O., I.M. dhe L.H., ka falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve apo votimeve në Kosovë, në atë mënyrë që me rastin e numërimit të votave të kandidatëve të subjekteve politike, ka hequr votat disa kandidatëve dhe ia ka shtuar kandidatëve tjerë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 748 (shtatëqind e dyzet e tetë) vota, dhe atë nga kandidatët e subjektit politik LDD 20 (njëzetë) vota, AKR 13 (trembëdhjetë) vota, VAKAT 1 (një) votë, LDK 315 (treqind e pesëmbëdhjetë) vota, SLS 22 (njëzet e dy) vota, VV 26 (njëzet e gjashtë) vota, AAK 15 (pesëmbëdhjetë) vota, PDAK 10 (dhjetë) vota dhe PDK 326 (treqind e njëzet e gjashtë) vota,

- me çka ka kryer veprë penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11, 15, 41,42,43,44,45,64 të KPK dheneneve 326, 357, 359, 365, 366 të KPP i shqipton,

## **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu qëi përckton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj** icili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen veprë të re penale,

E pandehura obligohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga **30 (tridhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.I.nr. 87D/2013 të datës 26.06.2015, ka akuzuar Y.H., F.M., F.I., H.B., F. L.-O., I.M. dhe L.H për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehuritt'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 09.01.2018 në të cilën mbrojtësi i të pandehurës F.M. av. A.R. e ka njoftuar gjykatën me shkrim se e njëjta jeton jashtë Kosovës, është e martuar në M. ndërsa me vendbanim të përkohshëm ndodhet në I., fakt ky të cilin gjykata e ka vërtetuar nga njoftimi zyrtar nga Stacioni Policor në F.K. se F.M. qe dhjetë vjet është e martuar në M., andaj me pajtimin e palëve konform nenit 36 të KPP, për shkak të efikasitetit të procedurës dhe për shkak të shmangies së stërzgjatjes së procedurës ka veçuar procedurën për të njëjtën me aktvendim të veçantë ka lëshuar urdhërarrest, ndërsa të njëjtën datë ka nxjerrë aktgjykim për të pandehurittjerë sipas aktakuzës.

Gjykataduke proceduar sipas aktakuzës së lartshënuar ndaj të pandehurës F.M., në seancën fillestare tëmbajtur me datë 26.07.2018 e njëjta në prani të mbrojtësit të saj av.A.R. sipas autorizimit, e vënë

në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht pranoi të tërësi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, për çka e pandehur theksoi se që nga koha e kryerjes së veprës penale e deri më sot nuk është zhvilluar asnjëherë procedurëtjetër penale ndaj saj, ndiehtë e pëndaure dhe kërkoi nga gjykata ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të pandehurës F.M. av.A.R. deklaroi se, është konsultuar me të mbrojturën e tij dhe pasi që e njëjta ka pranuar fajësinë dhe nuk ka qenë më parë e dënuar, i ka propozuar gjykatës që këto rrethana ti ketë parasysh në rastin e matjes së dënimit.

Prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga e pandehura meqë ka konsideruar se ky pranim është bërë në bazë të vullnetit të tyre të lirë, dhe duke qenë të vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, poashtu ka konsideruar se ky pranim është në përputhshmëri me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të të pandehurës për pranim fajësie dhe pajtimin të prokurorit të shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi fajësinë nga e pandehura, pasi është bindur se e njëjta ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se, ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuzën.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurës dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerr konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurës ekzistojnë elementet e veprës penale që u vihet në barrë, andaj pasi që më parë gjeti se e pandehura është penalisht përgjegjëse, të njëjtën e shpalli fajtor për veprën penale Mashtrimi në votime në bashkëkryerje nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK dhe, i shqiptoi dënim të paraparë ligjor, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pati parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin e shprehur për veprën e kryer, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti përtë pandehurën, andaj të njëjtësi përcaktoi dënim burgimi të cilin dënim i'a kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurës se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtës, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojnë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK dhe, në fund me bindje se e pandehura në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.20/18, me datë 26.07.2018**

**Sekretarja juridike  
Albulena Ademi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.